

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda,** Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve K. S. dhe A. B., për shkak të veprës penale Blerje, posedim, shpërlarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substanca psikotropike të kryera në bashkëkryerje nga neni 229 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.555-2/12 të dt.24.02.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.27.04.2017, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Feti Tunuzliu, të akuzuarve K. S. dhe A. B., të njëjtën ditë mori, dhe shpalli publikisht këtë:

## A K T G J Y K I M

**Të akuzuarit:**

**K. S.,** i biri i J. dhe K., e gjinisë K, i lindur me dt.*data e lindjes...*, në P, ku dhe tani jeton, lagja S. e R. rr."Sh. R." pn, me numër të letërnjoftimit *numri personal...*, i pamartuar, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar a dënuar, dhe

**A. B.,** i biri i V. dhe S., e gjinisë M., i lindur me dt.*data e lindjes...*, në P., ku dhe tani jeton, lagjen D. rr."M. V.", . / . nr., me numër të letërnjoftimit *numri personal...*, i pamartuar, ka të kryer fakultetin, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë e gjykuar.

## JANË FAJTORË

**Sepse:**

Me dt.31.07.2012 rreth orës 20:00, në fshatin Halilaq, komuna e Fushë-Kosovës, të akuzuarit në bashkëkryerje me të akuzuarin A. B.1 për të cilin është veçuar procedura penale, pa autorizim kanë shpërndarë dhe shitur substanca narkotike, dhe pas kontrollit të veturës Fiat, me ngjyrë hiri, me targa *numri i targave...*, të cilën e drejtonte i akuzuari K. S. si dhe pasagjerët në atë automjet, tani të akuzuarit A. B.1 dhe A. B., gjatë kontrollit nga pjesëtarët e PK-së, kanë gjetur dhe sekuestruar 4 qese të vogla të mbushura me bari të gjelbërt, të dyshuara për substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme 9.6gr., dhe pas ekzaminimit të këtyre substancave narkotike, pas ekzaminimit të mostrave të marra nga këto substanca narkotike është konstatuar se këto substanca janë të llojit kanabis (marihuanë) e që përmbajnë tetrahidrokanabionol (THC), pesha neto e përgjithshme e së cilës është rreth 8.51gr. -me këtë kanë kryer veprën penale Blerje, posedim, shpërlarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substance psikotropike të kryera në bashkëkryerje nga neni 229 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 50, 51, 52, 73, 74 dhe 374 par.1 dhe 3 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 të KPPRK, e:

## GJYKON

**Të akuzuarin K. S. ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 2 (dy) vitesh, i njeiti nuk kryen vepër tjetër penale, dhe

**DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 300 (treqind) Euro, të cilin dënim do ta paguaj në tri këste mujore, dhe ate në lartësi prej 100 (njëqind) euro për çdo këst duke filluar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

**Të akuzuarin A. B. ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 2 (dy) vitesh, i njeiti nuk kryen vepër tjetër penale, dhe

**DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 300 (treqind) Euro, të cilin dënim do ta paguaj në tri këste mujore dhe ate në lartësi prej 100 (njëqind) euro për çdo këst duke filluar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë, Gjykata ua zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i tejkalohet 6 muaj.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë, secili veç e veç shumën prej 20 (njëzetë) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet substanca narkotike me peshë të përgjithshme 9.6 gr., e cila është sekuestruar nga ana e policisë, si mjet i kryerjes së veprës penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP.nr.555-2/12 të dt.24.02.2017, kundër të akuzuarve K. S., A. B.1 dhe A. B., për shkak të veprës penale Blerje, posedim, shpërlarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substance psikotropike të kryera në bashkëkryerje nga neni 229 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.27.04.2017, në të cilën nuk ka prezentuar i akuzuari A. B.1, ndërsa nga memorandumimi zyrtar i Policisë së Kosovës i dt.26.04.2017, konstatohet se i njëjti jeton jashtë vendit, ashtu që kundër të njëjtit është veçuar dhe pezulluar procedura penale, ndërsa pas leximit të aktakuzës, të akuzuarit K. S. dhe A. B., e kanë pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale për të cilën janë akuzuar. Prokurori i shtetit nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarve për pranimin e fajësisë.

Meqë të akuzuarit e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklaratata e të akuzuarve për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtit edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pakontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit K. S. dhe A. B., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Blerje, posedim, shpërlarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substance psikotropike të kryera në

bashkëkryerje nga neni 229 par. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ashtu që të akuzuarit edhe i shpalli fajtorë, dhe ua shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se me vet faktin se të akuzuarit e pranuan fajësinë dhe se një pranim i tillë i fajësisë është në përputhshmëri me të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i propozon gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal të merr si rrethanë lehtësuese faktin se të akuzuarit e pranuan fajësinë për veprën penale të cilat i vihen në barrë, andaj i propozon që t'i shpall fajtorë dhe t'i gjykoj sipas ligjit.

Të akuzuarit në fund kanë deklaruar se janë penduar për veprën penale të kryer, kanë shprehur keqardhje për veprimin që kanë bërë, duke premtuar se nuk do t'i përsërisin në të ardhmen veprime të tilla, e kanë lut gjykatën që t'ua shqiptoj një dënim penal sa më të butë të mundshëm.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarit, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit, vlerësoi faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sigurtë që nga fillimi i kësaj procedure penale, sjelljen dhe qëndrimin e tyre shumë korrekt në gjykatë, moshën e re të tyre, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se të njëjtit kanë qenë të gjykuar më parë, pendimi i thellë i tyre për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtëve se në të ardhmen nuk do ti përsërisin asnjëherë këto veprime, andaj të akuzuarve ua shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarve, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin është marrë konform nenit 229 par.2 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.62/17, dt.27.04.2017**

**Procesmbajtësja**  
Mybera Latifi

**Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari**  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.